



## Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në gjykimin *Thaçi dhe të tjerët*, Trupi Gjykses bëri publik vendimin që lëshoi në janar lidhur me disa persona që ridorëzuan kërkesat për t'u pranuar si viktime, pas urdhrat të Trupit Gjykses për informacione shtesë. Trupi Gjykses vendosi të pranojë nëntë parashtrues kërkesash që fillimisht i kishte refuzuar pasi i kishin dorëzuar kërkesat pas afatit të përcaktuar nga Trupi Gjykses.

Në vendimin e janarit, gjykatësit dolën në përfundimin se për tetë prej parashtruesve nuk kishte qenë praktikisht e mundur t'i dorëzonin kërkesat para afatit dhe se ishte në interes të drejtësisë të shqyrtohej themelësia e kërkesës së parashtruesit të nëntë. Trupi Gjykses u bind se nëntë parashtruesit ishin viktime të krimeve që pretendohet se u kryen në vendet e përmendura në Aktakuzë gjatë periudhës kohore përkatëse.

Nëntë parashtruesit e pranuar kanë rrethana personale të ndryshme, banojnë në zona të ndryshme si dhe flasin gjuhë të ndryshme. Në të njëjtën kohë, duke qenë se ishin objekt i krimeve të pretenduara të ngjashme në rrethana përgjithësisht të ngjashme, u gjykua se kanë interes të përbashkët të marrin pjesë në proces dhe të kërkojnë të drejtat e tyre.

Rrjedhimisht, parashtruesit iu bashkuan grupit ekzistues të viktimeve pjesëmarrëse dhe përfaqësohen nga i njëjti mbrojtës.

Më 1 maj, Trupi Gjykses miratoi kërkesën e Prokurorisë që të gjitha palët në çështjen *Thaçi dhe të tjerët* të kenë qasje në versionet konfidenciale të Aktgjykimit dhe Aktgjykimit të Apelit në çështjen gjyqësore *Salih Mustafa*. Duke marrë parasysh se këto dy çështje përkohë në masë të konsiderueshme, Trupi Gjykses konstatoi se ekziston qëllim juridik legjitim për të kërkuar qasje në këto Aktgjykime. Bazuar në kërkesën e Prokurorisë dhe pas konsultimit me Trupin Gjykses dhe Panelin e Apelit në çështjen gjyqësore *Mustafa*, Trupi Gjykses konstatoi gjithashtu se miratimi i kërkesës nuk do të cenojë masat mbrojtëse në fuqi si dhe nuk do të përbëjë rrezik për viktimat dhe dëshmitarët. Sidoqoftë, Trupi Gjykses u rikujtoi palëve dhe pjesëmarrësve klasifikimin konfidencial të këtyre versioneve të Aktgjykimeve dhe se pjesët konfidenciale nuk duhet të nxirren për publikun.

Seancat në gjykimin Hashim Thaçi dhe të bashkakuarit rinisën të hënën, më 29 prill me dëshminë e dëshmitarit të 58-të të thirrur nga Prokuroria.

Dëshmitari i 59-të, Nuredin Abazi, filloi dëshminë të hënën dhe dëshmoi kryesisht në seancë të hapur. Sipas përmbledhjes së paraqitur nga Prokuroria, dëshmitari ishte anëtar i batalionit të UÇK-së në Budakovë dhe më vonë shërbeu si këshilltar juridik në zonën e Pashtrikut. Zotit Abazi iu bënë pyetje nga Prokuroria, ekipet e mbrojtjes dhe gjykatësit.





Të martën dha dëshmi dëshmitari i 60-të i thirrur nga Prokuroria. Pas këtyre dëshmive, seancat e gjyqimit për këtë javë përfunduan të mërkurën dhe do të rinisin të hënën, më 6 maj në orën 9:00 të mëngjesit.

Në çështjen *Sabit Januzi, Ismet Bahtijari dhe Haxhi Shala*, më 30 prill, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, me kërkesë të Mbrojtjes, shtyu afatin brenda të cilit z. Bahtijari duhet të dorëzojë formularët dhe dokumentet mbështetëse për të kërkuar ndihmë juridike në DHSK. Afati i ri është data 3 maj. Gjykatësi e mbështeti vendimin në përparimin e bërë në plotësimin e dokumenteve përkatëse.

## Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

